

## VENDIMET E BORDIT TË DATËS 25 prill 2019

Në mbledhjen e Bordit Ekzekutiv të Federatës të mbajtur më 25 prill 2019, me shumicë votash të anëtarëve u morën këto vendime:

### Vendimi Nr. 2019-09

#### *ITF Worldwide Coaches Conference 2019, Thailand (WCC)*

- ITF-i mbulon akomodimin dhe biletën për një drejtim (gjysmën e biletës).
- Nënkryetari i Federatës, z. Jeton Hadërgjonaj, që ka shprehur dëshirë të shkojë, emërohet të merr pjesë në WCC që do të mbahet nga 23-28 tetor 2019 në Tailandë, mirëpo merr përsipër të gjitha shpenzimet e tjera që nuk mbulohen nga ITF-i për këtë udhëtim.

### Vendimi Nr. 2019-10

#### *Aplikimi për Grant nga Komuna për “Prishtina Wheelchair Tennis Championships 2019”*

- Të aplikohet për grant nga Komuna e Prishtinës me projekti “Prishtina Wheelchair Tennis Championships 2019” për të përfutur mbështetje financiare për realizimin e këtij aktiviteti.

### Vendimi Nr. 2019-11

#### *Tëheqja nga “European Junior Championships 2019”, kategoria U16.*

- Në mungesë të lojtarëve për të garuar edhe në European Junior Championships 2019 edhe në Lojërat Olimpike Rinore në Baku 2019, që mbahen gjatë javës së njëjtë, Bordi vendos të tërhiqet pjesëmarrja nga “European Junior Championships – U16” që mbahet në Rusi.
- Vendimi është subjekt i konfirmimit të 4 tenistëve për Baku nga ana e KOK-ut.

### Vendimi Nr. 2019-12

#### *Blerja e tabelave për poentimin e pikëve në turne për klubet;*

- Miratohet rekomandimi i dalur nga Workshop-i për organizim turnesh, për blerjen e tabelave me ndryshim manual të gemave.
- Të blihen dhjetë sosh në momentin kur ka mjete të mjaftueshme në disponim, me buxhetin maksimal prej €500.



### **Vendimi Nr. 2019-13**

#### ***Takimi konsultativ me klubet***

- Miratohet propozimi për mbajtjen e një takimi konsultativ me Klubet në format workshop-i.
- Workshop-i do të shërbejë për t'i kuptuar brengat e Klubeve, çfarë ato presin prej Federatës por edhe Federata për tyre, obligimet reciproke, si dhe shoshitja e ideve për të zhvilluar dhe zgjuar interesimin për tenis.
- Takimi të mbahet 2-3 javë nga data e këtij vendimi;
- Kryetari Rexhepi do të shoqërohet edhe nga zyrtarë të tjerë të Federatës, ndërkohë që janë të ftuar nga një përfaqësues nga të gjitha Klubet.

### **Vendimi Nr. 2019-14**

#### ***Përzgjedhja e Selektorit U14***

- Pas refuzimit të ofertës për të qenë selektor i U14, Bordi ri-emëron z. Arian Ibrahim si Selektor për gruposhën U14.
- Vendimi hyn në fuqi nga 01 maj 2019.

### **Vendimi Nr. 2019-15**

#### **Hapja e llogarisë bankare në BPB**

- Bordi vendosi që të hapet llogaria bankare me Banka për Biznes (BPB). BPB ka përkrahur Ditën e Tenisit në Prishtinë dhe ka shprehur interesim për të përkrahur evenimente të tjera të ngjajshme. BPB njëherësh ka ofruar mirëmbajtje mujore shumë më të volitshme.
- Vendimi është subjekt i konfirmimit nga ana e Ministrisë së Federatës mund të ketë më tepër se një llogari bankare. Nëse kjo nuk lejohet, atëherë llogaria bankare ekzistuese me NLB të mshulet në favor të llogarisë me BPB.

### **Vendimi Nr. 2019-16**

#### **Politika për shpërndarje të rekuizitave 2019**

- z. Mërgime Mula emërohet të fillojë hartimin e rregullores për shpërndarje të topave, pajisjeve e rekuizitave, dhe format e tjera për përkrahje të Klubeve (dhe trajnerëve të certifikuar).

**Vendimi Nr. 2019-17**

***Premitë për Fed Cup dhe Davis Cup***

- Premia bazë e tenistëve, për pjesëmarrje, varet nga rankingu i tyre botëror në javën kur mbahen garat.
- Premitë për tenistët janë:

LLOJI			PREMIA
<b>Premia bazë</b>			€400-€1,000
Rankingu:	1-100	€1,000	
	101-300	€ 800	
	301-500	€ 600	
	501-1,000	€ 500	
	Të tjerët	€ 400	
<b>Bonus për meç të luajtur<sup>1</sup></b>			+€100
<b>Bonus për meç të fituar<sup>1</sup></b>			+€200
<b>Bonus për fitore të ekipit ndaj një shteti</b>			+€100
<b>Bonus për avancim në grupe</b>			+€500

*1) Për meçet çift, tenistëve iu ndahet bonusi në dysh.*

- Premitë për kapitenin e skuadrës janë:

LLOJI		PREMIA
<b>Premia bazë</b>		€400
<b>Bonus për fitore të ekipit ndaj një shteti</b>		+€100
<b>Bonus për avancim në grupe</b>		+€500

- Për anëtarët e tjerë të skuadrës caktohen mëditje sipas vendimeve të Bordit.
- Premitë për garat e tjera të reprezentacionit të Kategorisë “A”, pra garat që nuk janë Fed Cup apo Davis Cup, do të caktohen nga Bordi me vendime të veçanta.
- Ky vendim hyn në fuqi nga data 1 janar 2019.